

26, Prill 2023

Të Nderuar Prindër dhe Kujdestarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Po ju shkruajmë për t'ju informuar se **nxënësit e klasave 8-12 do të marrin pjesë në Provimet Keystone midis 15 Majit dhe 26 Majit 2023.**

Provimet Keystone ofrojnë informacion kritik në lidhje me përparimin akademik të nxënësve tuaj dhe janë gjithashtu **kërkesa për diplomim** nga shkolla e mesme në Pensilvani. Rezultatet individuale të studentëve nga këto vlerësime i ndihmojnë mësuesit të identifikojnë pikat e forta dhe fushat e rritjes së një studenti në mënyrë që të mbështesin mësimin e tyre. Rezultatet e provimit Keystone gjithashtu ofrojnë informacion për shkollat dhe drejtorinë për të mbështetur përmirësimin dhe planifikimin rreth kurrikulës dhe udhëzimit.

Provimet Keystone në Algjebër, Biologji dhe Letërsi janë me mandat shtetëror. Nxënësit zakonisht e marrin vlerësimin(et) në pranverë, teksa janë afër përfundimit të kursit(eve) Algjebra 1, Anglisht 2 dhe/ose Biologji. Çdo shkollë pritet të ketë 95% të nxënësve që marrin vlerësimet e Algjebërës, Biologjisë dhe Letërsisë. Nëse shkollat bien nën 95% të pjesëmarrjes, rezultati i performancës shtetërore për shkollën ndikohet negativisht. Gjatë periudhës së vlerësimit, është shumë e rëndësishme që nxënësit të ndjekin shkollën çdo ditë dhe të mbeten të regjistruar në shkollën e tyre aktuale. Për këtë arsye, kërkesat për transferime administrative do të shtyhen deri në fund të periudhës së vlerësimit, me përjashtime shumë të kufizuara.

Dokumentet e lidhura më poshtë ofrojnë informacion të rëndësishëm për administrimin e ardhshëm të Keystone. Ju lutemi rishikoni ato me kujdes. Ju gjithashtu duhet të merrni kopje të këtyre dokumenteve nga shkolla e fëmijës suaj dhe ato mund të gjenden në faqen tonë [“Ne fagen internetit Keystone”](#).

- [Udhëzuesi i Prindërve për Keystone /Keystone Parent Guide](#): Është një përmbledhje e Keystone në lidhje me burimet e drejtorisë për prindërit
- [Pyetjet e Bëra më Shpesh](#) / [Frequently Asked Questions](#): Një fletë faktesh nga Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë që ofron përgjigje për pyetjet e bëra shpesh
- [Karakteristikat dhe Akomodimet e Provimit Keystone](#) / [Keystone Test Features and Accommodations](#): Një shpjegim i veçorive dhe akomodimeve të provës, duke përfshirë një lidhje me Udhëzimet e plota të Akomodimit
- [Kodi i Sjelljes për Testuesit](#) / [Code of Conduct for Test Takers](#): Çfare të bësh dhe të mos bësh për studentët gjatë Provimit
- [Pajisjet Elektronike Letra e Prindit](#) / [Electronic Devices Parent Letter](#): Një letër për familjet që detajon politikën e Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë dhe pasojat për përdorimin e telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike gjatë provimit

Nëse keni pyetje të përgjithshme në lidhje me vlerësimet e drejtorisë, ju lutemi kontaktoni :“Office of Evaluation Research and Accountability [nëpërmjet formularit tonë të internetit](#). Nëse keni pyetje në lidhje me kërkesat e Drejtorisë për diplomim, ju lutemi kontaktoni :“Office of College and Career Readiness” duke dërguar email në: gradreq@philasd.org ose vizituar [faqen internetit e tyre](#).

Sinqerisht,

Dr. Tonya Wolford
Shefe -Vlerësimi, Studimi & Përgjegjësi

Translation and Interpretation Center
(4/2023)

Keystone Parent Notification - '22-'23 SY
(Albanian)